

Kampionati i minifutbollit "Porti dhe Sporti"
Shkollat "Olsi Lasku" dhe "16 shtatori" i Shijakut në finalen e 9 dhjetorit
02 Dhjetor 2011



Mbi 250 nxënës nga 16 shkolla të mesme të rrethit të Durrësit janë përfshirë në kampionatin e minifutbollit, që është organizuar nga Porti detar i qytetit me mbështetjen e disa institucioneve lokale.

Mesditën e së premtes në pallatin e sportit "Ramazan Njala" të Durrësit u përcaktua edhe finalistja e dytë e këtij kampionati që ka nisur një muaj më parë.

Skuadra e shkollës "Olsi Lasku" fitoi me rezultatin e thellë 6-2 ndaj ekipit të shkollës "Turgut Ozal", duke fituar të drejtën të konkurojë në finalen e javës së ardhshme.

Përballë saj më 9 dhjetor do të jenë futbollistët e rinj, nxënës të shkollës së mesme "16 shtatori" të Shijakut.

Specialisti i futbollit Edmond Zalla, vlerëson se kampionati i minifutbollit ka qenë shumë i fortë, por vlera e tij e vertetë qëndron te përfshirja e nxënësve në veprimtari sportive. Pallati i sportit gjatë këtyre takimeve ka qenë gjithnjë plot me të rinj dhe të reja që mbështesin bashkëmoshatarët e tyre, çka i shërben largimit nga veset që i kanosen kësaj moshe-tha më tej ish-futbollisti i njohur.

“Nisma e Portit Detar duhet përshëndetur, pasi ajo kërkon të krijojë një hapësirë veprimtarish pozitive pikërisht për moshat e reja-u shpreh Vladimir Ajazi, një nga futbollistët më të mirë të viteve 1970-1980.

Ekipet e shkollave të mesme publike dhe jopublike që nga 4 nëntori kanë zhvilluar 16 takime mes tyre, të cilat janë organizuar pjesërisht në kompleksin “Niko Dovana” dhe pjesërisht në pallatin e sportit “Ramazan Njala”.

Nisma “Porti dhe sporti” gjeti mbështetjen e Drejtorisë rajonale të arsimit, Federatës shqiptare të futbollit, etj.

